



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna Drenas/Glogoc

Zyra e Personelit

01Nr. MM-35173 dt. 24.06 /2019

Bazuar në nenin 12 ,paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe në Ligjin Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, me qëllim të ofrimit të shërbimeve të veçanta, Komuna Glogoc/Drenas, U.D.Udhëheqëse e Personelit :

SHPALLË KONKURS PUBLIK
me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Për angazhim afatshkurter konform nenit 12 paragrafit 4, të Ligjit nr. 03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, (Marrëveshje për Shërbime të Veçanta).

Pozita: e vendit të punës:

koefficienti :

1 (një) Inspektor të ambientit

7

Përshkrimi i vendit të punës :

- Inspektimi i ujrave të zeza(kanalizimeve) sipas kërkesave, si dhe ndotëve të ajrit;
- Shqyrtimi i kërkesave të banorve nga lëmia e mjedisit rreth ndotjes;
- Inspektimi i operatorve legal (gurëthyesve), si dhe marrja e masave ndaj kompanive që e shfrytëzojnë materialin guror në prona shoqërore pa pelqime nga Drejtoritë përkatëse, MMPH-rë dhe KPMM
- Merr pjesë në hartimin e planeve dhe rregulloreve nga lëmia e Mjedisit ;
- Marrja e masave për hyrje në sistem të menaxh.mbeturina;
- Marrja e masave për ndotësit e mjedisit;
- Inspektimi i tregjeve, thertorëve etj.;
- Kryen punë tjera sipas kërkesës së eprorit.

Qëllimi i vendit të punës: *Mbikëqyrja e zbatimit dhe implemetimit të Ligjeve dhe Rregulloreve Komunale që kanë të bëjnë me këtë lëmi. Bashkëpunon me Drejtorin e Drejtorisë dhe njëherit kordinon punët në këtë sektor rreth kompetencave që kanë të bëjnë me mbrojtjen e Ambientit. Nga kjo pozitë kërkohet të arrihet një mjedis i pastër konform legjislacionit si dhe shfrytëzimi i të gjithë mekanizmave të cilët kanë qasje në edukim për zhvillim të qëndrueshëm mjedisor.*

Shkathtësitë e kërkuara: *(kualifikimet, përvojat si dhe aftësitë dhe shkathtësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës)*

- Diplomë Universitare - Ambient, Kimi, Teknologji Ushqimore,
- Njohuri në fushën e programeve të kompjuterit ;Word, Excel, Power Point, Access,
- Aftësi komunikimi me kolegët, palët, eprorët dhe rrethin,
- Aftësi për përmbushjen e detyrave dhe punëve nën presion,

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja bëhet në pajtim me nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-149 të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr.04/L-077, Për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Në këtë konkurs zbatohet një procedurë e thjeshtuar e rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur 8 (tetë) ditë kalendarike, nga dita e publikimit **24/06/2019** deri më **01/07/2019**, që konsiderohet dita e fundit e mbylljes së konkursit.

Kohëzgjatja e angazhimeve është 5.5 muaj.

Vendi ku mund të merren dhe të dorëzohen aplikacionet:

Në objektin e komunës, kati i parë sporteli nr.10-12, gjatë orarit të punës.

Aplikacionit i bashkangjiten kopjet dokumentacionit për kualifikim arsimor dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme për këtë vend pune, për të cilin konkurrohet.

U.D.Udhëheqëse e Personelit

Hanumshahe Shabani
Hanumshahe Shabani